

**Njoftim për përqendrim me të cilin FARMACIA Holding d.o.o. për shërbime, Kroaci
do të fitojë kontroll mbi Barnatoren DELTIS FARM, Kroaci
(lënda nr. 08-13/2026)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 14.01.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin FARMACIA Holding d.o.o. për shërbime, me seli në rr. Miramarska cesta nr. 23, Zagreb, Republika e Kroacisë, do të fitojë kontroll mbi Barnatoren DELTIS FARM me seli në rr. Josipa Vargoviqa 4/IV, Koprivnicë, Republika e Kroacisë nëpërmjet shitblerjes së pjesëve

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

FARMACIA Holding d.o.o. për shërbime është shoqëri tregtare veprimtaria e së cilës përfshin prodhimin dhe qarkullimin e barnave dhe produkteve të tjera mjekësore, e veçanërisht prodhimin, testimin klinik, importin, ndërmjetësimin (brokerimin), tregtinë me shumicë dhe tregtinë me pakicë të barnave dhe produkteve mjekësore, duke përfshirë edhe transportin dhe aktivitetet e marketingut. FARMACIA Holding d.o.o. për shërbime është në pronësi të plotë të ATLANTIC GRUPA dioničko društvo za unutarnju i vanjsku trgovinu, me seli në rr. Miramarska nr. 23, Zagreb.

ATLANTIC GRUPA dioničko društvo za unutarnju i vanjsku trgovinu është pronar i vetëm i Atlantic Trade d.o.o. Kroaci i cili është ortak me pjesëmarrje prej 75% në shoqërinë: Shoqëria për qarkullim dhe shërbime ATLANTIC TRADE SHKUP SHPK Ilinden, me seli në rr. 35 nr. 33, Ilinden dhe me veprimtari Tregti me shumicë me sheqer, çokolllatë dhe ëmbëlsira prej sheqeri.

Gjithashtu, Atlantic Trade d.o.o. Kroaci, paraqitet edhe si ortak i vetëm i shoqërisë Atlantic Grand SHPK Shimanovci (Atlantic Grand d.o.o. Šimanovci Srbija), e cila nga ana tjetër është prezente në tregun në Republikën e Maqedonisë së Veriut si themelues i vetëm i Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime ATLANTIC GRAND SHPKNJP import – eksport Shkup me seli në rr. Shar Planina nr. 6, Gjorçe Petrov, Shkup dhe me veprimtari Tregti me shumicë me kafe, çaj, kakao dhe erëza.

Barnatorja DELTIS FARM është shoqëri veprimtaria e së cilës përfshin tregtinë me pakicë të barnave dhe pajisjeve mjekësore, produkteve dietike dhe shtesave ushqimore (suplementeve), si dhe kozmetikës për higjienë personale, kujdes dhe mbrojtje të fytyrës dhe trupit. Barnatorja DELTIS FARM nuk ka degë dhe e njëjta nuk është prezente në tregun në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Për nevojat e vlerësimit të përqendrimit në fjalë, parashtruesi i njoftimit propozon që tregu përkatës i produkteve të përkufizohet si tregu i tregtisë me pakicë të produkteve farmaceutike dhe pajisjeve mjekësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose përmes e-mailit: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision në afat prej 10 ditësh nga dita e shpalljes së këtij njoftimi.

20.01.2026

Shkup